


PERFORMANCA E OShP-së

Gjatë periudhës janar – shtator 2023 në OShP janë deponuar gjithsej 748 ankesa. Ankesa të zgjidhura rezultojnë të jenë 632 sosh apo mbi 84% e ankesave janë zgjidhur brenda kësaj periudhe, ndërkaq në shqyrtim janë 116 ankesa.



Ndryshimi i kundërligjshëm i rregullave për themelimin e paneleve shqyrtuese

01

OShP ka ndryshuar dy herë rregullat për themelimin e paneleve shqyrtuese, duke rritur vlerat e lëndëve të ankesave që do të trajtohen në panele shqyrtuese individuale deri në 900%

02

Ndryshimet e rregullores janë bërë në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik dhe në mungesë të plotë të transparencës dhe përfshirjes së palëve të interesuara.

03

OShP në Rregulloren e amendamentuar nuk ka përcaktuar nëse rregullorja ka fuqi prapavepruese, kështu që vazhduar të trajtoj ankesat e deponuara para hyrjes në fuqi të Rregullores sipas rregullave të reja.




Afati ligjor për zgjidhjen e ankesave shprehur në ditë.



Mesatarja e zgjidhjes së ankesave shprehur në ditë.

Pjesëmarrja e anëtarëve të Bordit në shqyrtimin e prokurimit, në panele individuale, për lëndët e ankesave me vlerë deri në 300,000.00Eur.



Shumica e lëndëve të trajtuara në OShP janë bërë përmes paneleve shqyrtuese individuale. INPO vë në pikëpyetje objektivitetin dhe karakterin e vendimmarrjes kolegjiale të OShP-së.